


Afazia është një **çrregullim gjuhësor**.

Njerëzit që vuajnë nga afazia mund të kenë probleme me **të folurit, të kuptuarit, të lexuarit, të shkruarit, dhe kryerjen e mbledhjeve**.



Shkaku i afazisë është gjithmonë **dëmtimi i trurit**.

Në shumicën e rasteve, kjo është një **goditje cerebrale**, por edhe një **aksident** ose një **tumor** mund të shkaktojnë afazinë.

Dikush vuan nga një goditje cerebrale kur **qarkullimi i gjakut** në tru **papritur** ndërpritet. Kjo mund të ndodhë në dy mënyra: një enë gjaku mund të **bllokohet** ose një venë gjaku mund të fillojë **të rrjedhë**.

Blokimet:

Si rezultat i një **trashje të murit vaskular** (trombozë) ose për shkak të një **mpiksje të gjakut** (emboli), një enë gjaku mund të bllokohet. Kjo quhet një **infarkt cerebral**.



Rrjedhja:

Një **zonë e butë** mund të formohet brenda një ene gjaku (aneurizëm); kjo pjesë e butë mund **të bëhet poroze** dhe të fillojë **të rrjedhë** ose **të çahet**. Kjo quhet **hemorragji cerebrale**.



Doktorët, një goditje cerebrale e quajnë zakonisht një CVA: një **Aksident Cerebral Vaskular**.

Gjuha ka një vend të rëndësishëm në jetën tuaj të përditshme. Ne **flasim** me njerëz të tjerë, ne **lexojmë** gazeta, ne **punojmë** dhe **mësojmë**. Ne përdorim gjithashtu gjuhën për të formuluar **mendimet** tona dhe për të bërë **plane për të ardhmen**.

Njerëzit që vuajnë nga afazia mund të kenë **probleme** me shumë gjëra që më parë, para afazisë, kanë qenë shumë normale:

- Kryerja e një bisede
- Të folurit në shoqëri ose në një ambient të zhurmshëm
- Leximi i një libri, gazete ose reviste, ose dhe tabelat e trafikut anës rrugës
- Të kuptuarit dhe të treguarit e shakave
- Të kuptuarit e programeve televizive dhe radiofonike
- Të shkruarit e një letre dhe plotësimi i një formulari
- Kryerja e një telefonate
- Kryerja e mbledhjeve, mbajtja mend e numrave, ose veprimi me paratë
- Thënia e emrit të tyre ose të emrave të anëtarëve të familjes së tyre



Njerëzit që vuajnë nga afazia kanë vështirësi me gjuhën, por ata **nuk janë të çmendur!**

Shumica e njerëzve që vuajnë nga afazia zbulojnë se jeta e tyre ka **ndryshuar** shumë. Gjëra që kanë të lehta më parë, tani kërkojnë më shumë **kohë dhe përpjekje**. Shumë njerëz që vuajnë nga afazia ndihen **të pasigurt** dhe **shqetësohen** se si do të vazhdojnë. **Ndihma** dhe **mbështetja** nga ambienti i tyre është për këtë arsye shumë i rëndësishëm. Takimet me njerëz të tjerë që vuajnë nga afazia ndihmojnë gjithashtu. Njerëzit me afazi **e kuptojnë** njeri-tjetrin edhe **pa fjalë**.

Çfarë mund të bëni vetë?

- **Tregojuni njerëzve** që vuani nga afazia
- Mbani një **skedë të vogël** me vete, që tregon se ç'do të thotë afazi
- Përpiquni të bëni të qartë se çfarë doni të thoni duke përdorur **gjeste, vizatime, shkrime, ose duke treguar** në rast se të folurit nuk ecën mirë
- Kërkojuni **ndihmë** familjarëve dhe miqve
- **Planifikoni paraprakisht**, përgatituni paraprakisht për një bisedë në mendimet tuaja ose në letër
- Tregojuni shqetësimet tuaja të tjerëve; mos vazhdoni të shqetësoheni vetë

